

ISLAMI
DHE
LIRIA E
BESIMIT

JO DHUNË NË FE!

DR. USAMA HASAN

*Në emër të Zotit, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!*

JO DHUNË NË FE ! *ISLAMI DHE LIRIA E BESIMIT*

Dr. Usama Hasan

www.IslamAndRF.org

Përmbajtja

Përmbajtja.....	4
Rasti mbi lirinë e besimit dhe relaksimin e ligjeve ndaj blasfemisë	4
1. Vështirësia e përcaktimit blasfemisë 6	
2. Abuzimi i përhapur i ligjeve ndaj blasfemisë	10
3. Parimi kur'anor “Në fe nuk ka dhunë ! ”	11
4. Besimi nën ndikimin e detyrimit është i pavlefshëm.....	14
5. Burimet e shkrimeve të shenjta të Islamit nuk e kriminalizojnë blasfeminë 15	
6. Vetëm Zoti mund të gjykojë dhe dënojë sakrilegjin (plaçkitjen e tempujve) 19	
7. Fryma kur'anore është e tillë që të diskutohet dhe debatohet lirisht mbi çështjet e besimit	22
Debati i lirë në historinë islame.....	25

8.	Vetëpërmbytja në fytyrën e provokimit 29	
	Përfundim.....	35
	Shtojca Një: Ligji mesjetar i Sheriatit mbi dënimin me vdekje për apostazinë* nga Islami	36
	Analiza e haditheve kryesore të cilat citohen kur mbështetet dënimi me vdekje për mohimin e fesë (apostazi).....	37
	Pikëpamjet e juristëve tradicionalë dhe mesjetarë 'mbi një dënim me vdekje për apostazinë	43
	Jurisprudenca bashkëkohore myslimane mbi apostazinë	46
	Implikimet e këtyre zhvillimeve përfshijnë:	50
	Pikat kyçe:.....	51
	Shtojca Dy: Një reflektim rreth Islamit dhe Lirisë së Fesë.....	52

Përmbajtja

Rasti mbi lirinë e besimit dhe relaksim e ligjeve ndaj blasfemisë

Është e rëndësishme të dënojmë orvatjet që provokojnë urrejtje, fanatizëm fetar ose anti-fetar, dhe dhunë, si përgjigje ndaj provokimeve, dhunës kuturu të revoltave, me pretekstin e të qenit të fyer. Sidoqoftë, ky dokument paraqet një rast të Islamit për lirinë e besimit, kundërshton idenë e forcimit të ligjeve ndaj blasfemisë dhe mbështet rishqyrtimin e ligjeve të tilla në mbarë botën, duke u bazuar në argumentet e mëposhtme:

1. Blasfemia është e vështirë për t'u përcaktuar në një kontekst global sepse blasfemia e një personi mund të jetë liria e besimit për dikë tjetër.
2. Ligjet ndaj blasfemisë, të cilat janë shumë të hapura ndaj abuzimit, janë përdorur nga qeveritë represive për të ushtruar diskriminim kundër pakicave

fetare.

3. Nga perspektiva islame, mosdetyrimi në çështjet fetare është një parim themelor kur'anor; besimi i vërtetë është i bazuar në vullnetin e lirë dhe zgjedhjen e lirë.

4. Besimi dhe praktikimi i besimit fetar me detyrim nuk është i drejtë, prandaj është edhe kundër- produktiv.

5. Nuk ka asnjë sanksion të qartë në Kur'an apo edhe në Sunet (mësimet e Profetit Muhamed) për kriminalizimin dhe ndëshkimin e blasfemisë. Në fakt, e kundërta është e vërtetë; ato pak tekste të shkrimeve të shenjta që janë keqinterpretuar në këtë pikë, i referohen situatave të luftës, ndërsa jurisprudenca e ashpër e kohës mesjetare islame mbi blasfeminë u zhvillua disa shekuj pas vetë Profetit Muhammed.

6. Shkrimet e shenjta islamike promovojnë besimin dhe respektin për simbolet e shenjta; çdo dënim për

dhunimin e tyre është shpirtëror dhe i botës tjetër, aspak biznes i legjislacionit të kësaj dhe dënimit të kësaj bote.

7. Fryma kur'anore është e tillë që të diskutohet dhe debatohet lirisht mbi çështjet e besimit dhe fesë për t'ju mundësuar njerëzve, si agjentë të lirë dhe të moralshëm, që të bëjnë zgjedhje të informuara në lidhje me çështje të tilla.

8. Debati dhe diskutimi ideal duhet të jetë i sjellshëm, i respektueshëm dhe i civilizuar; kur ai nuk është i tillë, karakteri Muhammedan duhet t'iu përgjigjet fyerjeve dhe sjelljeve të pacivilizuara si dhe dhunës me durim, me falje dhe mëshirë.

Konsideratat e mësipërme diskutohen më në detaje si më poshtë.

1. Vështirësia e përcaktimit blasfemisë

Blasfemia është e vështirë për t'u përcaktuar në një kontekst global;

blasfemia e një personi mund të jetë liria e besimit për dikë tjetër.

Për shkak të natyrës së besimit fetar, besimi i një personi shpesh nënkupton se një besim tjetër është i gabuar dhe ndoshta edhe fytes, kështu që kjo përbën blasfemi. Për shembull, fetë e mëdha botërore shpesh kanë shumë formulime dhe besime të ndryshme në lidhje me Zotin, Muhamedin, Jezusin, Budën dhe hyjnitë hinduiste, si edhe për çështje të ndryshme etike dhe sociale. Ka qasje intelektuale dhe fetare për të pajtuar fetë e mëdha botërore, si nëpërmjet traditave mistike dhe filozofive shumëvjeçare, por këto priren të jenë të marginalizuara nga debati publik.

Kritikët e një feje të caktuar, apo të fesë në përgjithësi, si dhe të konvertuarit nga një fe në një tjetër, lehtësisht mund të akuzohen për blasfemi dhe të diskriminohen mbi këtë bazë, ndoshta duke u bërë kështu edhe subjekt i kodeve penale.¹

¹ Për shembull, shih “Compass Direct,”

Ironikisht, myslimanët shpesh janë shkelësit më të keq të rregullit kur vjen puna për të blasfemuar kundër feve të tjera, megjithatë po ata, ngrejnë më së shumti zërin kur simbolet e tyre të shenjta fyhen. Për shembull, leksionet ofensive kundër hebrenjve janë të zakonshme në shoqërinë dhe median egjiptiane. Nxitja e urrejtjes kundër të krishterëve ka çuar në sulme të dhunshme të turmave në Egjipt,² Pakistan dhe Indonezi.³

“Blasphemy” Laws in Egypt, Sudan Threaten Converts, May 2011 [Ligjet e blasfemisë në Egjipt, Sudani kërcënon të konvertuarit, Maj 2011]

http://www.compassdirect.org/english/country/egypt/article_112328.html.

² Ibid.

³ Të drejtat e njeriut, ligjet ndaj blasfemisë zbulohen: Pasojat e kriminalizimit të “Përgojimit të Feve,”

Përditësuar-Mars 2012,

http://www.humanrightsfirst.org/wp-content/uploads/Blasphemy_Cases.pdf.

Një shembull tjetër i kësaj është tregimi kur'anor rreth një komuniteti izraelit i cili u testua në lidhje me ligjin e Sabatit; tradita tolerante islame gjithmonë e ka lexuar këtë tekst në introspektivë, duke nxjerrë mësim për çifutët, të krishterët dhe myslimanët.

Megjithatë, myslimanët fundamentalistë, predikuesit e urrejtjes, rregullisht e citojnë gabimisht këtë histori për të justifikuar referimin e hebrenjve (dhe herë pas here, edhe të krishterët) si "majmunë dhe derra."⁴

Duhet të theksohet se sjellje të tilla si kjo dënohen në Kur'an:

Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), që, kur masin për veten, e marrin masën të plotë, ndërsa,

⁴ Shih Usama Hasan, When Words Are Immutable [Kur fjalët janë të pandryshyeshme], The Guardian's Comment Is Free, 2010 <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/belief/2010/feb/26/quran-translation-tafsir>, për më shumë detaje.

kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë. A nuk mendojnë ata se do të ringjallen në një Ditë të madhe, Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?! (83:1-6)

2. Abuzimi i përhapur i ligjeve ndaj blasfemisë

Ligjet ndaj blasfemisë dhe abuzimit janë tejet të hapura, ato janë përdorur nga qeveritë shtypëse për të ushtruar diskriminim kundër pakicave fetare.

Ka shumë raste të dokumentuara lidhur me këtë. Një raport i kohëve të fundit nga një OJQ e OKB-së detajon me shembuj se si ligjet e blasfemisë janë përdorur që të:

- (i) ndrydhin diskutimin dhe kundërshtinë në sferën publike,
- (ii) ndezin shpërthimet e dhunës së turmave,
- (iii) shkelin lirinë e fesë, mendimit, ose

bindjeve dhe

(iv) janë përdorur si një armë për të zgjidhur mosmarrëveshjet private.⁵

Shumica dërrmuese e dhjetëra e rasteve të dokumentuara në raportin e mësipërm përfshin akuzat për blasfemi kundër Islamit në vendet me shumicë myslimane, edhe pse ka një pjesë të vogël që bën përjashtim në këtë model dominues.

3. Parimi kur'anor “Në fe nuk ka dhunë !”

Nga perspektiva Islame, mos-detyrimi në çështjet fetare është një parim themelor kur'anor: besimi i vërtetë është i bazuar në vullnetin e lirë dhe zgjedhjen e lirë.

(i) Ajeti kur'anor, " Në fe nuk ka

⁵ Të drejtat e njeriut së pari, Ligjet ndaj Blasfemisë zbulohen: Pasojat e Kriminalizimit të “Përgojimit të Feve”, Përditësuar Mars 2012, http://www.humanrightsfirst.org/wp-content/uploads/Blasphemy_Cases.pdf.

dhunë !" (2:256) është proverbial dhe konsiderohet si shprehje e një vlere themelore islame, sidomos pasi ndodhet menjëherë pas "Vargut të Fronit" (2: 255), që është i përkushtuar për madhështinë e Zotit, u përkushua nga ana e Profetit Muhamed si "ajeti më i madh në Kur'an."

Në mënyrë domethënëse, Ibn'Abbasi, një kushëri dhe dishepulli (Sahabi) i Profetit Muhamed dhe një nga autoritetet më kryesore në komentimin e Kur'anit shpjegon se ky ajet (2:256) kishte zbritur lidhur me shembujt ku sahabët kishin fëmijë të cilët ishin konvertuar në judaizëm dhe krishterizëm. Sahabët ishin të ndaluar, në bazë të këtij ajeti që t'i detyronin fëmijët e tyre për t'u kthyer në Islam.⁶ Pra, ky ajet jo vetëm që ndalon konvertimin në Islam me detyrim, por gjithashtu edhe lejon që njerëzit të largohen nga besimi Islam vullnetarisht.

⁶ Shih komentet në Kur'an 2:256 nga Taberiu, Qurtubiu dhe Ibn Kathiri, e gjithashtu edhe në internet në: <http://quran.al-islam.com>.

(ii) Një ajet tjetër i qartë kur'anor dhe vendimtar në këtë drejtim është në vijim, në adresë të Profetit Muhamed: “Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë! Ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?!” (10:99)

Ibni Kethiri, një komentator kryesor i komentimit tradicional të Kur'anit, shpjegon këtë ajet në lidhje me shumë ajete të tjerë duke pohuar se, çështjet e besimit janë çështje mes individëve dhe Zotit. Asnjë person tjetër nuk mund të ndërhyjë në mes tyre.⁷

(iii) Një ajet i ngjashëm citon Profetin Nuh (Noa) që retorikisht pyet popullin e tij: “A do t'ju detyronim të pranoni këtë mesazh pa dëshirën tuaj?” (11:28)

Komentatorët tradicionalë konfirmojnë se ky ajet do të thotë, po ashtu, se nuk ka asnjë detyrim në fe. Taberiu dhe Ibni Kethiri gjithashtu japin kuotën e Katadës,

⁷ Komentari i Ibni Kathirit rreth Kur'an-it, 10:99.

një autoritet i hershëm, duke thënë: " Pasha Zotin, nëse Nuhu ishte në gjendje të detyronte njerëzit e tij që të kishin besim, ai do të kishte bërë atë, por kjo nuk ishte brenda pushtetit të tij."⁸

4. Besimi nën ndikimin e detyrimit është i pavlefshëm

Besimi fetar dhe praktikimi i tij i detyruar, qartësisht, nuk është real dhe i vërtetë - kjo është vërejtur dhe theksuar nga teologët islamikë dhe juristët përgjatë shekujve, që nga ditët e hershme të Islamit.

Kjo deklaratë vijon qartësisht dhe logjikisht nga deklarata e mëparshme. Gazaliu, njëri prej teologëve më të njohur të Islamit, deklaroi prerazi se si besimi apo

⁸ Shih komentaret rreth Kur'an-it 11:28 nga Taberiu, Kurtubiu, Ibn Kathiri dhe Xhelalejni, gjithashtu edhe në faqen e internetit: <http://quran-al-islam.com>.

mosbesimi përfshijnë besim aktiv ose mosbesim, dhe jo një pasivitet apo detyrim.⁹

Prandaj, kurrë nuk është në interes të publikut përpjekja për të detyruar bindjet dhe besimin ndër njerëzit e tjerë, si dhe të kufizohet e drejta e tyre për të pyetur, kritikuar dhe për të eksploruar. Nxitja e urrejtjes dhe e dhunës është një çështje tjetër që nuk është e kufizuar në kuadratin fetar dhe mund të mbulohet nga ligjet e përgjithshme civile.

5. Burimet e shkrimeve të shenjta të Islamit nuk e kriminalizojnë blasfeminë

⁹ Shih Hamza Yusuf, Who Are the Disbelievers? [Kush janë Mosbesuesit?, Xhournali i Stinëve], Zaytuna Institute, USA, pranverë 2008, fq 30-50. I disponueshëm të lexohet në internet në: <http://sandala.org/wp-content/uploads/2011/04/Who-are-the-Disbelievers.pdf> .

Nuk ka asnjë sanksion të prerë në Kur'an dhe në Sunet (mësimet e Profetit Muhamed) për kriminalizimin dhe ndëshkimin e blasfemisë: në fakt, e kundërta është e vërtetë. Edhe ato pak tekste biblike që janë keqinterpretuar në këtë pikë, në fakt i referohen situatave të luftës, ndërsa jurisprudenca e ashpër mesjetare islame mbi blasfeminë u zhvillua disa shekuj pas vetë Profetit Muhamed.

Siç është cekur më herët, Kur'ani afirmon lirinë e besimit dhe të fesë,¹⁰ ku përmes disa vargjeve mënyrë specifike shihet mbrojtja e këtij parimi, si për hebrenjtë ashtu edhe për të krishterët, edhe pse disa nga besimet e këtyre të fundit do të përbënin blasfemi, (*kufër* - mosbesim), nga pikëvështrimi mysliman; p.sh. refuzimi i

¹⁰ I vetmi përjashtim nga kjo sipas shumë autoriteteve, ishte rasti i mushrikëve arabë (idhujtarët ose politeistët), sepse ata në mënyrë të vazhdueshme persekutuan myslimanët dhe iu shpallën atyre luftë me qëllim eliminimi komplet. Ai rregull i veçantë historik është i vjetruar (i dalë mode) që nga koha e sulmit ndaj Arabisë në shekullin e shtatë të erës së re.

Profetësisë së Muhamedit, refuzimi i Jezusit si Krisht si dhe hyjnizimi i Krishtit.

Disa nga ajetet lidhur me këtë janë si më poshtë:

“Ata që besojnë dhe ata që ndjekin shkrimet e shenjta hebraike , dhe të krishterët dhe sabianët , çdokush që beson në Zot dhe në Ditën e Fundit, dhe bëjnë punë të drejta do të kenë shpërblim tek Zoti i tyre , për ata nuk do të ketë as frikë as brenga”. (2:62 & 5:69)

Ky ajet ka një mesazh të qartë universal që favorizon interpretimet përfshirëse, ku shpëtimi është i hapur përmes një shumëllojshmërie të përpjekjeve të sinqerta fetare, përtej atyre ekskluziviteteve ku kriteret për shpëtim janë kuptuar sikur ato mund të përmbushen vetëm nga myslimanët besnikë.

(i) *“Ata që besojnë dhe ata që ndjekin shkrimet e shenjta hebraike , dhe sabianët e të krishterët , zjarrputistët si dhe idhujtarët, Zoti do të gjykojë mes tyre në Ditën e Gjykimit: sepse Zoti është dëshmitar i të gjitha gjërave”*. (22:17)

Ky ajet nuk garanton shpëtimin e të gjitha grupeve fetare të përmendura, por përsërit se gjykimi hyjnor në mesin e tyre do të manifestohet në jetën e përtejme. Ai sugjeron një qasje të qartë, të arsyeshme, praktike dhe pragmatike islamike për bashkëjetesën paqësore mes grupeve të ndryshme fetare: çdo bashkësi fetare ka të drejtë të ndjekë rrugën e vet pa i dëmtuar të tjerët, ndoshta duke besuar dhe duke argumentuar se ajo është më e mirë se të tjerat, mirëpo vetëm Zoti do të gjykojë në mes tyre në Jetën e Përtejme.

Ajeti që shpesh keqkuptohet, “*vrisni ata kudo që t'i gjeni*”. (2:191, 4:89 & 4:91) i referohet armiqve paganë dhe myslimanëve tradhtarë në kohë lufte. Ai nuk i referohet hebrenjve, pavarësisht nga pretendimet e përsëritura të rreme të shkrimtarëve si Melanie Phillips. Kjo është e qartë nga vargjet paraprijëse të tilla si: “*Luftoni në rrugën e Zotit ata që ju sulmojnë, por mos mëkatoni: Zoti nuk i do mëkatarët*”. (2:190)

Është e vërtetë se, sipas traditës islame, një ose dy poetë paganë u vranë për

përqeshjen e Pejgamberit Muhamed, por këto ishin veprime në kontekstin e luftës. Në kulturën arabe të shekullit të 7 – të, e dominuar nga një traditë gojore, poezia është përdorur edhe për propagandë dhe luftë psikologjike, dhe ajo me të vërtetë në mënyrë efektive ishte përdorur nga vetë Profeti Muhamed, përmes Hassan bin Thabitit dhe Abdullah bin Rawahas, si dy nga thurësit më të aftë të strofës me tekstin: “vargjet tuaja dëmtojnë shumë më tepër se sa shigjetat tona”, aftësi të cilën e kishte vërejtur Profeti tek Hassani.¹¹

6. Vetëm Zoti mund të gjykojë dhe dënojë sakrilegjin (plaçkitjen e tempujve)

Shkrimet e shenjta islame promovojnë besimin dhe respektin për simbolet e shenjta; çdo dënim për dhunimin e tyre është shpirtëror dhe i botës tjetër, dhe aspak biznes i legjislacionit dhe dënimit të

¹¹ Sahih Muslim.

kësaj bote.

Kjo është e vërtetë edhe për përqeshjen e Zotit, Profetit Muhamed dhe Kur'anit, sepse edhe kjo përbën blasfemi kundër Islamit. Ka shumë vargje që e zbulojnë këtë pikë, për shembull:

(1) *Thuaj: "Talluni po deshët! Zoti sigurisht që do ta nxjerrë në pah atë së cilës ju i drubeni. Nëse i pyet, ata do të përgjigjen: "Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim." Thuaj: "A mos vallë me Zotin, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?" Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar. Nëse ne i falim disa prej jush (për shkak se u penduan), do t'i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë fajtorë (nuk u penduan për talljen që bënë)".* (9:64-66)

Për përqeshjen e besimit, ky ajet përmend edhe faljen edhe dënimin hyjnor; kjo e fundit është kuptuar që ndodh në jetën e përtejme, siç janë shprehur komentuesit klasikë.

(ii) *Vërtet, Zoti e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij lutën për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me “selam”! Pa dyshim, ata që fyejnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Allahu i mallkon ata në këtë botë dhe në tjetrën. Ai ka përgatitur për ta ndëshkim poshtërues. Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë ata i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe kanë bërë gjynah të qartë. (33:56- 58)*

Këto vargje kanë frymëzuar gjithmonë përgjigjen dinjitoze myslimane në fytyrën e provokimit; për të adhuruar Zotin dhe Profetin dhe për të lënë sjelljen fyese kundër Zotit, Muhamedit dhe besimtarëve në dorë të Zotit, që Ai të merret me të në jetën e pëртеjshme. Përrjashtim i vetëm për këtë është shkelja penale e jetës, pasurisë dhe nderit të njerëzve, për të cilat ligjet janë më se të nevojshme për të lehtësuar drejtësinë dhe dëmshpërblimin.

7. Fryma kur'anore është e tillë që të diskutohet dhe debatohet lirisht mbi çështjet e besimit

Fryma kur'anore është e tillë që të diskutohet dhe debatohet lirisht mbi çështjet e besimit dhe fesë për t'ju mundësuar njerëzve, si agentë të lirë e me moral, të bëjnë zgjedhje të informuara në lidhje me çështje të tilla.

Vargje të rëndësishme, por pak të njohura kur'anore në këtë drejtim janë:

(i) *“Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Zoti i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët”.* (39:17-18)

Zemahsheri, komentuesi i njohur i Kur'anit, pohon se ky ajet mund të interpretohet si vijon: Njerëzit kanë të drejtën e interpretimeve të ndryshme të shkrimeve të shenjta (dhe për këtë arsye, edhe të Islamit dhe fesë në përgjithësi), si

dhe të drejtën për të ndjekur çdo gjë që ka kuptim për ta.¹² Kurtubiu, për ta zgjeruar domethënien e këtij ajeti edhe më tej citon Ibn Abasin duke shpjeguar "*fjalën*" për të nënkuptuar të gjitha fjalët e fjalimet, dhe jo vetëm Fjala Hyjnore e regjistruar në shkrimet e shenjta.¹³ Ky parim kur'anor, ku njerëzit dëgjojnë njëri-tjetrin dhe ndjekin atë që ata e konsiderojnë si më të mirë, ofron një bazë të mëtejshme islamike për bashkëjetesë paqësore në mes të komuniteteve të ndryshme fetare dhe sekteve.

(ii) "*Për çdo gjë që ju nuk pajtoheni, vendimi për të i takon Zotit*". (42:10)

Një pikëpamje tradicionale e këtij ajeti është se ai i referohet Ditës së Gjykimit, të ngjashme me ajetin 22:17 që u diskutua më

¹² Komentet e Zemahsheriut në Kur'an 39:17-18, Al-Keshshaf, Dar al-Kutub al-'Arabi, n.d.

¹³ Shih komentarin rreth Kur'an-it 39:18 nga Kurtubiu, gjithashtu gjenden në internet në <http://quran.al-islam.com>.

sipër,¹⁴ dmth se njerëzit duhet t'ia lenë gjykimin për mosmarrëveshjet e tyre Zotit në jetën e pëртеjme.

(iii) *Thuaj: "Kush ju furnizon nga qiejt e nga toka?" Thuaj: "Ai është Zoti. Vërtet, ose ne ose ju jemi në rrugë të drejtë ose në humbje të dukshme!"* (34:24)

Ky ajet siç është e qartë nga konteksti i tij mekas, ishte pjesë e një debati mes Islamit dhe idhujtarisë dhe politeizmit pagan i përhapur në Arabi, gjatë jetës së Muhamedit. Kur'ani përsërit në raste të shumta se monoteizmi Islam ishte shumë më superior ndaj idhujtarisë primitive arabe. Megjithatë, në këtë ajet, për hir të argumentit, Profeti ishte i udhëzuar që të mbajë një qëndrim neutral; le të paraqesim argumentet tona - njëri prej nesh mund të ketë të drejtë ose jo. Ky parim kur'anor ishte një nga frymëzimet për traditën e

¹⁴ Shih Tafsir el-Xhelalejn, komentet për Kur'anin 42:10, gjithashtu gjenden në internet në <http://quran.al-islam.com>. Shih gjithashtu komentarin e Zemahsheriut mbi të njëjtin ajet.

pasur islame të mendimit, debatit dhe diskutimeve të lira.

Debati i lirë në historinë islame

Në historinë islame, disa prej kalifëve aktivisht inkurajuan debate teologjike ndërfitare të nivelit të lartë, lidhur me çështjet themelore të besimit. Disa nga këto debate janë mbajtur në gjykatat e vetë Kalifit me rabinët kryesorë të asaj kohe, peshkopët dhe teologët islamikë. Për më tepër, mendimtarët më të njohur myslimanë, filozofë dhe poetë, shpreheshin hapur mbi pikëpamjet "heretike" pa u përballur me ndjekje penale. Për shembull, shkencëtarët dhe filozofët më të mëdhenj myslimanë të tillë si El-Kindi, Er-Razi, El-Farabi, Ibn Sina (Avicena), dhe Ibn Rushdi (Averroes) ishin denoncuar si heretikë dhe ishin akuzuar për blasfemi nga teologët "konservativë" suni myslimanë, si Gazaliu dhe Ibn Tejmije.

Në fakt edhe udhëheqës e figura "konservative" janë denoncuar shpesh si

heretikë dhe janë akuzuar për blasfemi në jetën e tyre nga të tjerët dhe shpesh janë bërë edhe subjekt burgimesh, rrahjeje dhe dhune prej turmave; kjo është e vërtetë, për shembull disa prej figurave më të mëdha të Islamit Suni si: Ebu Hanifja, Ahmed bin Hanbeli, Esha`riu, Buhariu, Gazaliu, Kadi Ebu Bekri, Ibni Arabiu, Ibn Tejmije, Subki dhe Ibni el-Kajjimi.

Sponsorizuar nga shteti, *mibna* (Mu'tezilite), apo racionalizmi kërkues (827-847) krijuar nga Halifi Abasid al-Mamun kundër besimeve tradicionaliste dhe mësimëve të tilla si ato të Ahmed bin Hanbelit, u braktis përfundimisht nga kalifët e dy dekadave të mëvonshme. Shumica e pjesëtarëve të besimit Islam mësoi nga kjo përvojë përgjithësisht se, çfarë marrëzie është të përpiqesh t'ju imponosh besimet fetare të tjerëve, duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e gjerë e tradicionale, jurisprudencën, interpretimet ligjore, racionalitetin, intelektualizmin, filozofinë dhe teologjinë e shkrimeve të shenjta islamike që kishin lulëzuar brenda dy shekujve të Pejgamberit Muhamed.

Sipas një të krishteri akademik të asaj kohe, ky shpërthim i mendimit të tillë brenda një hapësire të shkurtër kohe ishte i pashembullt në historinë njerëzore¹⁵.

Shembuj të tjerë të mendimit të lirë, përfshijnë edhe satirën ndaj praktikës bashkëkohore fetare dhënë nga poetët myslimanë. Për shembull, një ndër poetët kryesorë gjatë kohës abaside ishte Ebul Atahija (748-828), i cili komentoi shkëlqyeshëm, më pak se dy shekuj pas Profetit se:

Ekzistojnë vetëm dy lloje popullatash në mesin e njerëzimit:

“Fetarë të pamend dhe mendimtarë të pa fe”.

Atahija u akuzua për herezi, por kurrë nuk u ndoq penalisht për këtë. Ai vetëm sa u burgos për prishjen e qejfit të një kalifi duke shkruar poezi dashurie lidhur me një

¹⁵ Wael Hallaq, Introduction to Ibn Taymiyya Against the Greek Logicians [Prezantim në Ibni Tejmija kundër logjikuesve grekë], Clarendon, 1993.

nga konkubinat e tij.

Një shembull tjetër është poeti i shekullit të 12-të, Omar Kajami, *Rubairet* e të cilit u njohën dhe u pëlqyen në të gjithë botën anglisht-folëse, që nga publikimi i përkthimit të tyre në shekullin e 19-të, përkthimin e të cilave e bëri poeti Viktorian Eduard Fitzgerald. Përmes *Rubaireve*, Kajami shpreh në mënyrë përbuzëse ata që ndjekin rrugë fetare apo shqetësohen lidhur me misteret si parajsja dhe ferri, jeta pas vdekjes dhe fati, si dhe ndaj këndimit të lavdeve atyre që zhyten në konfuzion prej dehjes nga pirja e vazhdueshme e verës.

Edhe pse disa myslimanë të devotshëm kanë neveri për disa nga ndjenjat e shprehura nga Atahiya dhe Kajami, është fakt i historisë islame që ato ndjenja janë shprehur zakonisht nga poetët gjatë kohës së tyre, d.m.th 900-1200 vjet më parë.

8. Vetëpërmbytja në fytyrën e provokimit

Debati dhe diskutimi ideal duhet të jetë i sjellshëm, i respektueshëm dhe i civilizuar: kur ai nuk është i tillë, karakteri Muhammedan duhet t'iu përgjigjet fyerjeve dhe sjelljeve të pacivilizuara dhe dhunës me durim, me falje dhe mëshirë. Ata që pretendojnë se ndjekin Islamin dhe Profetin Muhamed duhet të tregojnë karakteristika të tilla dhe jo të provokohen prej akteve të dhunës dhe gjakderdhjes të çmendur, apo që të bëjnë përpjekje për të mbyllur lirinë e mendimit dhe të shprehjes.

Vargjet kur'anore në vijim janë vetëm disa nga ato që lartësojnë virtytet e durimit dhe faljes në përgjigje ndaj provokimit dhe fyerjes:

(i) *“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit”!* (7:199)

(ii) *“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin me modesti nëpër*

Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqja qoftë"! (25:63)

(iii) *"Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Zotit. Edhe para teje (o Muhamed!), shumë të dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin (që kanë pësuar), derisa u ka ardhur ndihma Jonë, sepse askush nuk mund t'i ndryshojë vendimet e Allahut. Ti tashmë ke dëgjuar për ata të dërguar". (6:33-34)*

(iv) *"Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre, andaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur! Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja"! (15:97-99)*

Incidentet në vijim nga jeta e Pejgamberit, marrë nga literatura e hadithit më autentike që paraqet traditën kanonike islame, ilustron se si Muhamedi praktikisht manifestoi mësimet sublime të Kur'anit në lidhje me maturinë, durimin, vetëpërmbytjen dhe faljen:

(i) Armiqtë e Profetit në Mekë iu referuan atij si Mudhammam ("shpesh mallkuar"), një përmbysje e Muhamedit ("shpesh vlerësuar"). Profeti thjesht tha: "Fjalët e tyre nuk kanë aplikim për mua, sepse ata janë duke përdorur një emër të rremë, ndërkohë që unë jam Muhamedi".¹⁶

(ii) Kur Profeti shkoi në qytetin malor të Taifit të predikonte mesazhin e tij, njerëzit e atij vendi e injoruan atë dhe nxitën rininë për të hedhur gurë kundër tij, duke e lënë me këmbë të përgjakura. Engjëlli Xhebrail erdhi tek ai dhe ofroi ndihmë për të shtypur popullin e Taifit në mes të maleve, duke pas fuqinë për të bërë kështu. Por Muhamedi iu përgjigj: "Mos e

¹⁶ Në "Vjershat Satanike" (1988) Selman Ruzhdi përdori emrin mesjetar anti-islam, korrupsionin e krishterë të Profetit për karakterin e figurës kryesore të novelës së tij "Mahound". Hadithi i mësipërm sugjeron një përgjigje të qartë profetike që mund të parafrazohet kështu: "mos u bëni merak, meqë ai nuk është emri im sidoqoftë!"

bëj atë: Unë shpresoj se një ditë, pasardhësit e tyre do të adhurojnë Një Zot". Brenda një dekade apo dy, gjithë popullsia e Taifit ishte konvertuar në Islam.

(iii) Profetit iu kërkua në mënyrë të përsëritur për të mallkuar armiqtë e tij, të cilët kishin persekutuar, torturuar dhe vrarë myslimanët dhe ishin duke u përpjekur për të zhdukur ata. Ai u përgjigj, "Unë u dërgova si mëshirë për njerëzit, jo si ai që i mallkon ata".

(iv) Një grup njerëzish erdhën në shtëpinë e Profetit dhe e përshëndetën atë me es- samu alejkum ("vdekja qoftë mbi ty"), në vend të përshëndetjes "selamun alejkum" ("paqja qoftë mbi ju"). Aishja u provokua nga kjo dhe iu përgjigj atyre: "Mallkimi i Zotit qoftë mbi ju!" Muhamedi e qortoi atë duke i thënë: "Zoti është i butë dhe e do butësinë".

(v) Profeti kishte një detyrim të hollash ndaj një beduini. Kur ky i fundit erdhi dhe kërkoi shlyerjen e borxhit dhe i tërhoqi gunën Profetit në mënyrë të dhunshme aq

sa ja plagosi keq qafën. Kur dishepujt e tij kërkuan hakmarrje, ai u përgjigj: “Lëreni të qetë, pasi një kreditor ka të drejtë të thotë fjalën e tij”.

(vi) Profeti një herë shpërndau plaçkat e luftës në mesin e myslimanëve. Njëri prej tyre e akuzoi atë për padrejtësi dhe për favorizime. Edhe pse Profeti e qortoi gojarisht atë, ai nuk ndërmori asnjë veprim të mëtejshëm kundër tij, pavarësisht faktit që duke e akuzuar profetin për padrejtësi është një lloj sikur të kryesh blasfemi.

(vii) Profeti mësoi, "Person i fortë nuk është ai që hedh kundërshtarin e tij gjatë një ndeshje mundjeje; person i fortë është ai që kontrollon veten kur zemërohet."

(viii) Një njeri erdhi tek Profeti dhe në mënyrë të përsëritshme iu lut atij, “Të lutem më këshillo.” Në çdo rast, Profeti iu përgjigj, “Mos u zemëro!”.

Dijetarët myslimanë kanë shpjeguar se kjo këshillë përfshin shmangin e çdo situatë që

ka gjasa ta zemërojë njeriun pa qenë nevoja për të. Kjo sigurisht vlen edhe për shikimin e filmave, karikaturave fyese, libra rreth Profetit apo simbole të tjera të shenjta.

(ix) Abdullah bin Ubeji ishte udhëheqësi i hipokritëve të Medinës të cilët ishin konvertuar në Islam për shkak të pozicionit dominues të Islamit atje, në krahasim me komunitetet hebreike, të krishtera dhe politeiste. Megjithatë, hipokritët vazhdimisht i tradhtonin myslimanët, duke përfshirë edhe tërheqjen e tyre në minutën e fundit prej ushtrisë myslimane në prag të Betejës së Uhudit. Pas një incidenti tjetër tradhtar, Umer bin el- Hatab dhe të tjerë këmbëngulën që tradhtarët duhet të ekzekutoheshin, një hap ky që ishte brenda rregullave të luftës në atë kohë. Megjithatë, Profeti Muhamed shkëlqyeshëm u përgjigj: “Lërinia ata se pastaj popujt e tjerë do thonë se ‘Muhamedi vret shokët e tij’.”

Ky incident tregon se Profeti ishte jashtëzakonisht i shqetësuar për reputacionin e Islamit dhe myslimanëve.

Fanatikët dhe inatçorët e sotëm që bërtasin “vrasje blu” për çdo fyerje ndaj Islamit, real apo të imagjinuar, do të bënin mirë të mësonin nga shembulli i Profetit për t’u vetëpërmbajtur, sidomos kur tani që ka një ndryshim të rëndësishëm. Thirrjet për hakmarrje shpesh thyejnë ligjet e shoqërive ku ato bëhen.

Përfundim

Islami historikisht ka pasur një traditë të fortë të tolerancës dhe lirisë së mendimit dhe debatit, edhe në lidhje me aspektet themelore të besimit. Diskutimet rreth besimit dhe besimi fetar në vetvete, përfshijnë medoemos deklarata që mund të jenë ofenduese për të tjerët dhe interpretohen si blasfemi. Përgjigja islame ndaj provokimit bazohet në dinjitet, spiritualitet dhe falje. Kjo traditë e të qenit të hapur dhe bujarë është në nevojë urgjente për t’u ringjallur në shumicën e vendeve dhe shoqërive myslimane sot, sidomos duke pasur parasysh dhunë e shumtë e të tmerrshme, të gjeneruar nga

intoleranca fetare dhe fanatizmi.

Shtojca Një: Ligji mesjetar i Sheriatit mbi dënimin me vdekje për apostazinë* nga Islami

* Braktisjen e fesë islame, dalja nga feja islame.

Për fat të keq, interpretimet mesjetare të Sheriatit janë dominuar nga ideja se braktisësit e Islamit, përkatësisht myslimanët që e lënë fenë e tyre ose konvertohen në një tjetër, duhet të vriten. Ky rregull që gjendet në të gjitha tekstet e mëdha të jurisprudencës mesjetare dhe që ende mësohen në seminarët islamike dhe universitetet në mbarë botën, e kundërshton në mënyrë blatonte parimin kur`anor se "*Në fe nuk ka dhunë*", dhe ishte bazuar në disa hadithe (traditat që i atribuohen Profetit Muhamed, me të drejtë apo gabimisht) gjetur në koleksionet kryesore të Hadithit të saktë e burimor.

Analiza e haditheve kryesore të cilat citohen kur mbështetet dënimi me vdekje për mohimin e fesë (apostazi).

Më poshtë vijon një diskutim i shkurtër i dy haditheve më të njohura në lidhje me këtë:

A. I pari mes këtyre haditheve është veçanërisht i njohur për shkak të përfshirjes së tij në koleksionin e shkurtër por të mirënjohur të traditave themelore profetike, “*dyzet hadithe*” nga Imam el-Neveviu (1234-1278). Teksti i këtij hadithi është si vijon:

Abdullah bin Mesudi transmetoi se i Dërguari i All-llahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Gjaku i një myslimani nuk mund të derdhet ligjërisht përveç se në një nga këto tre [instanca]; personi i martuar që shkel kurorën, një jetë për një jetë si dhe ai i që braktis fenë e tij dhe e lë bashkësinë.¹⁷

¹⁷ An- Nawawi, Forty Hadith [Hadithi i Dyzetë], trans. D.Johnson-Davies& E.Ibrahim, Islamic

Vini re se burimet parësore të këtij hadithi, Buhariut dhe Muslimit, janë konsideruar si dy koleksionet me autentike të hadithit në Islamin Sunni-Islam, dhe shumë komente janë shkruar rreth tyre.

Në një shembull përfaqësues të pikëpamjeve shkollare e klasike, shkollari sirian i shekullit të 13-të Imam Neveviu komenton në pjesën përkatëse të këtij hadithi në këtë mënyrë: “Ai zbatohet në përgjithësi për çdo fe-mohues nga Islami, çfarëdo lloj apostazie qoftë, zbatimi është i tillë që është e detyrueshme për të vrarë atë nëse ai nuk kthehet në Islam. Njerëzit e dijes thonë se kjo gjithashtu përfshin këdo që e lë bashkësinë përmes herezisë [bidat], rebelimi [baghy] ose të ngjashme si to. Ajo gjithashtu përfshin rebelët heretik [Havarixhët],”¹⁸

Texts Society, 1997, Hadith No. 14.

¹⁸ An-Nawawi, Sharh Sahih Muslim (Commentary on Sahih Muslim) [komentari on Sahih Muslim],

Në mënyrë të ngjashme, dijetari egjiptian i shekullit të 15-të Ibn Haxher el-‘Askalani citon në mënyrë aprovuese Neveviun dhe bashkëkohësin e tij Ibn Dakik el-‘Id, i cili tha: “Ka konsensus se apostazia legalizon vrasjen e një njeriu; rasti i gruas është

mbi Hadithin në fjalë, Kitab al-Kisas wal-Diyat (Book of Retaliation and Blood-Money) [Libri i hakmarrjes dhe i parave të përgjakura], no. 1676; gjithashtu gjendet në internet në <http://hadith.al-islam.com/Page.aspx?pageid=192&BookID=34&TOCID=772>. Havarixhët originalë ishin myslimanë të devotshëm, por kjo devotshmëri e tepruar i çoi në ekskomunikim dhe vrasje të myslimanëve të tjerë, përfshi edhe Imam Ailun, Kalifin e katërt të Islamit. Termi shpesh përdoret që të përshkruajë sektet politike dhe fetare që janë ekstremiste dhe që theksojnë rebelim kundër autoriteteve “jo- islamike” dhe që kënaqen me ekskomunikimin (takfir) e myslimanëve që nuk pajtohen me ta. Ironikisht, Imam Neveviu miraton vrasjen e çdokujt të cilin “Myslimanët ortodoksë-konservativ” e quajnë si braktisës të besimit Islam.

kontestuar.”¹⁹

Siç është zgjeruar më poshtë, mendimi bashkëkohor mysliman e ka hedhur poshtë këtë pikëpamje, duke lexuar “braktisjen e bashkësisë” në hadith, si kusht për vendosjen e një tradhtie të rëndë për çdo dënim që do të aplikohet në kohët më të hershme. Në kohë të tilla të lashta, besimi - besnikëria shpesh barazohej me besnikëri politike dhe për këtë arsye, duke u lënë besimi, ishte e ngjashme me tradhti politike, sidomos në situata kur komunitetet e ndryshme fetare kanë jetuar në mënyrë efektive në gjendjelufte.

B. Abbas Abdullah bin ' ka transmetuar se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë, “Kushdo që ndryshon fenë e tij, vriteni”- (*men bedele*

¹⁹ Ibn Hajar al-‘Asqalani, Fath al-Bari(komentari mbi Sahih Bukhari) nën hadithin në fjalë. Buhari, Kitab al-Diyat(Libri i parave të Gjaket) nr. 6878; gjithashtu i disponueshëm në <http://hadith.al-islam.com/Page.aspx?pageid=192&BookID=33&TOCID=3788>.

dinehu fa'ktuluhu) - transmetuar nga Buhariu dhe të tjerët.

Konteksti i këtij hadithi do të diskutohet më vonë. Në një shembull ekstrem të jurisprudencës tradicionale, imam Neveviu, në komentarin mbi Hadithin e mësipërm “A” nën *komentarin e tij për hadithin Dyzet*, citon hadithin “B” për të mbrojtur pozicionin literalist të shkollës shafite se kushdo që ndryshon fenë e tij duhet vrarë, përfshirë edhe “një hebre i cili konvertohet në krishterim dhe anasjelltas”!. Ky pozicion literalist thotë që të gjithë që konvertohen nga njëra fe në tjetrën duhet të vriten, me përjashtim të atyre që konvertohen në Islam. Dijetari i shekullit të 20-të, Muhamed Reshid Rida, në shënimet e tij për komentarin mbi “dyzet hadithet”, kritikoi Neveviun për mbështetjen e këtij pozicioni. Sipas pikëpamjes së Rida-së, Hadithi B duhet të kuptohet në dritën e Hadithit A, i cili në mënyrë të qartë vlen vetëm për të konvertuarit nga Islami.

Të dy, si Rida dhe Neveviu marrin qasje literale: Problemi me një qasjeje të tillë është theksuar nga konkluzionet ekstreme, nxjerra nga Neveviu dhe autoritetet e tjera si Shafiu. Mendimi bashkëkohor mysliman do të pajtohej me Rida-n që Hadithi B duhet të kuptohet në dritën e teksteve të tjera të tilla si Hadithi A, dhe se konteksti modern i ndryshuar si dhe fryma origjinale islame e bën të domosdoshëm shfuqizimin e dënimit me vdekje ose çdo dënim për braktisje feje. Mendimi bashkëkohor mysliman kështu kërkon të pajtojë këto hadithe me pasazhet kur'anore të cituara më herët. Pajtimi (kuadrimi) i teksteve të mëvonshme është një parim tradicional i jurisprudencës.

Konteksti i hadithit

Dijetari bashkëkohor Taha Xhabir el-'Elwani konteston vërtetësinë e këtij hadithi, por gjithashtu argumenton se, edhe nëse ai është autentik, ai iu referohej kompleteve tradhëtare të armiqve jo myslimanë të Islamit, që pretendonin të ktheheshin në Islam dhe pastaj të linin

besimin me shpresën se disa besimtarë do të ndiqnin shembullin, siç u përmend në Kur'an (3:72).²⁰

Pikëpamjet e juristëve tradicionalë dhe mesjetare 'mbi një dënim me vdekje për apostazinë²¹

1) Shkolla hanefite arsyetoi se të rriturit, meshkujt (por jo femra) nga Islami duhet të dënohen me vdekje në bazë të hadithit të dytë, siç u diskutua më sipër.

2) Shkolla malikite u shpreh se të gjithë murtedat e rritur, meshkuj apo femra, duhet të dënohen me vdekje për shkak të rrezikut që ata paraqesin, sepse mund të marrin armët dhe të luftojnë kundër

²⁰ Për më shumë detaje shih T.J al-Alwani, *Apostasy in Islam – A Historical and Scriptural Analysis*, [Apostazia në Islam- Një Analizë Historike dhe skripturale], The Institute of International Islamic Thought [Instituti Ndërkombëtar i mendimit islamik], London/Washington 1432/2011, kapitulli 4.

²¹ Al-Awani, Kapitulli 5.

bashkësisë myslimane. Kjo është pasi atyre t'ju jetë dhënë një mundësi që të pendohen. Për shembull, Ibn' Abd el- Berr ka pohuar se " Nuk ka asnjë mosmarrëveshje mbi dënimin me vdekje për apostazi."²²

3) Shkolla shafite thoshte se murtedat duhet të vriten meqë politeizmi dhe mosbesimi (kufri) janë arsye të mjaftueshme për të vrarë njerëz. Përjashtimi i vetëm për këtë janë dhimmitë, jo-muslimanët të cilët janë të mbrojtur nga autoriteti mysliman në këmbim për pagesën e një tatimi për - frymë, xhizja.²³

²² Al-Awani, fq 77&101-4.

²³ Al-Alwani, fq 104-9; shih gjithashtu Recep Senturk, *Sociology of Rights: Human Rights in Islam between Communal and Universal Perspectives* [Sociologjia e të Drejtave: të Drejtat e Njeriut në Islam mes Perspektivave Komunale dhe Universale], Emory University, Law School, 2002 për një ekspozitë të shkëlqyer të ndryshimeve themelore mes qasjeve komunale (Shafi'i) dhe atyre universale (Hanefi), ndaj të drejtave njerëzore në Islam, si dhe një histori të zhvillimit Osman lidhur me të drejtat e njeriut dhe demokracinë bazuar në qasjen universale

4) Shkolla hanbelite thoshte në mënyrë të ngjashme si Maliki dhe Shafiu, që murtedat si meshkuj dhe femra duhen dënuar me vdekje, pasi t'u jenë dhënë tre ditë kohë që të pendohen.

5) Shkolla imamite (Shia i dymbedhjetë) thoshte se myslimanët e lindur, të cilët apostazojnë duhet të ekzekutohen pa j'u dhënë asnjë mundësi pendimi. Murtedat të cilët janë konvertuar në Islam nga një besim tjetër duhet që t'i jepet një mundësi për t'u penduar. Murtedat femra që nuk pendohen nuk duhen vrarë, por duhen burgosur.

6) Shkolla dhahirite (literale), përfaqësuar nga Ibn Hazmi, u shpreh se të gjitha murtedat duhen ekzekutuar. Ibn Hazmi ka deklaruar se ajeti kur'anor "Nuk ka dhunë në fe", shfuqizohet ose vlen vetëm për njerëz të veçantë . Dijetari bashkëkohor Alwani përshkruan

Hanefi.

diskutimin dhe qëndrimin e Ibn Hazmit si të papajtueshëm, vetë- kontradiktor, të ngatërruar dhe konfuz.

7) Shkollat zejditë dhe ibaditë u shprehën se që të gjithë mosbesuesit meshkuj dhe femra duhen ekzekutuar pasi apostazitë e tyre përbëjnë një deklaratë potenciale ose reale të luftës ndaj kombit Mysliman.²⁴

Jurisprudenca bashkëkohore myslimane mbi apostazinë

Jurisprudenca mesjetare mbi apostazinë është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme dhe në mënyrë progresive kohëve të fundit, megjithëse shumë bashkëkohës myslimanë tradicionalistë nuk duket se janë në dijeni të zhvillimeve të tilla, dhe ja disa shembuj të tyre:

²⁴ Për përmbledhjen e pesë shkollave shih al-Alwani, fq 109-116.

1) **Reformat osmane:** Sulltanati osman është konsideruar nga të gjithë islamikët modernë si kalifati i vetëm legjitim i kohës së vet. Dekreti Gulhane (Hatt-i-Sharif), i vitit 1839 premtoi reforma të shumta, duke përfshirë heqjen totale të xhizjes apo ndonjë tatim tjetër mbi jo-myslimanët, duke i dhënë kështu status të barabartë shtetësie për çifutët, të krishterët dhe myslimanët. Kjo u pasua nga një kod i ri penal në vitin 1843 që ka tentuar të ndjekë pjesën tjetër të Evropës në modernizimin dhe përditësimin e trashëgimisë së vetë fetare. **Në vitin 1844, dënimi me vdekje për apostazinë nga Islami u shfuqizua.** Kodi Penal osman i vitit 1858 është bazuar në kodin e Napoleonit 1810, dhe hoqi mënjanë dënimet tradicionale islame.²⁵

²⁵ Ishtiaq Hussain, The Tanzimat(1839-1876); Secular reforms in the Ottoman Empire, Faith matters, 2011 gjithashtu i disponueshëm edhe në: <http://faith-matters.org/images/stories/fm-publications/thetanzimat-final-web.pdf>.

Shejh Abdul Hakim Murad (aka Dr. Tim Winter), një dijetar i shquar britanik mysliman, komenton mbi reformat osmane kështu, “Kalifati osman, përfaqësuesi i lartë i Islamit Sunit, formalisht shfuqizoi këtë dënim në periudhën e të ashtuquajturave reformat e Tanzimatit, që prej vitit 1839 Shejh el-Islam, kreu suprem i gjykatave dhe kolegjeve fetare, ka ratifikuar këtë ndryshim të madh në doktrinën tradicionale ligjore. Ai u vuri në dukje se nuk ka asnjë ajet në Kur'an që parashtron një dënim për apostazinë (edhe pse kapitulli 5 vargu 54 dhe kapitulli 2 ajeti 217, parashikojnë një dënim në botën tjetër). Gjithashtu theksohet se dilemat në hadith (thëniet e Profetit) sugjerojnë se apostazia është një kundërvajtje kur kombinohet me krimin e tradhtisë.”²⁶

²⁶ Abdal Hakim Murad, “On Faith: Muslims Speak Out – What Islam Really Says about Violence, Human Rights and Other Religions,” [“Mbi Fenë: Myslimanët flasin- Çfarë thotë Islami në të vërtetë për dhunën, të drejtat e njeriut dhe fetë e tjera], Washington Post /

2) Në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, **Al-Az-hari i Egjiptit**, insttucioni mijëvjeçar, që është aktualisht një nga autoritetet më me influencë fetare në botës islamike ndoqi Osmanët lidhur me dënimin me vdekje për apostazi. “Debati shkaktuar nga reforma Osmane vazhdoi kur Universiteti al-Az-har në Kajro, autoriteti suprem fetar në botën arabe, lëshoi një fetva formale (dekret fetar) në vitin 1958, e cila konfirmoi ndalimin e ligjit klasik në këtë fushë.”²⁷

3) Edhe **Këshilli Evropian për Fetva dhe Kërkim**, si një organ bashkëkohës i juristëve tradicionalistë , duke përfshirë disa udhëheqës islamikë , ka miratuar të kuptuarit e haditheve të cituara më lart si një gjë që do të thotë se, vetëm braktisja e fesë shoqëruar me tradhti politike është e

Newsweek July 2007, riprodhuar tek:
<http://ageofjahilyah.wordpress.com/2007/09/01/abdal-hakim-murad-on-jihad-apostasy-rights-of-muslim-women>.

²⁷ Murad (2007).

dënueshme.²⁸

Implikimet e këtyre zhvillimeve përfshijnë:

(i) Pretendimi se ekziston një konsensus mbi një dënim vdekje për apostazi është fals.

(ii) Ata të cilët pretendojnë se një ndryshim i tillë për dënimin me vdekje është “kufri (blasfemi)”, kundërshtojnë vetveten duke njohur Kalifatin Osman si “Islamik”.

(iii) Ky debat u zgjidh nga osmanët dhe al- Az-harin , vetëm për t’u ri- hapur nga fundamentalistët modernë dhe Islamikë të cilët kështu u rebeluan kundër

²⁸ Fatawa al-Majlis al –Urubbi-lil-Ifta’ val-Buhuth (Fatwas of the European Council for Fatwa and Research) [Fatvetë e Këshillit Europian për Fatvetë dhe Kërkim] e disponueshme në formë të printuar dhe ne internet në <http://www.e-cfr.org/>.

traditës , sesa të ringjallnin atë. Në prill të vitit 2013, Këshilli i Lartë i dijetarëve fetarë të Marokut thuhet se bëri thirrje për riprezantim të dënimit me vdekje për femohuesit nga Islami.²⁹

Pikat kyçe:

1) Dënimi mesjetar me vdekje për apostazi është qartësisht në kundërshtim me parimin kur`anor “Nuk ka dhunë në fe !”.

2) Kjo është njohur përfundimisht nga autoritetet kryesore islamike, të tilla si; Kalifati Otoman dhe Al-Az-hari, të cilët shfuqizuan dënimin me vdekje në shekujt e 19 dhe 20, respektivisht.

“Dyzyet Hadithet” vepra popullore e dijetarit të shekullit të 13-të, Imam Neveviu, mësohet në mbarë botën, si për fillestarët

²⁹ <http://morocconewstribune.com/morocco-high-council-of-ulemass-death-sentence-fatwa-on-apostates-sparks-controversy/>.

ashtu edhe për studentët e avancuar të Islamit. Megjithatë, ai përmban një hadith që është përdorur shpesh për të justifikuar dënimin me vdekje për femohuesit në përgjithësi. Është detyrë e të gjithë mësuesve të tanishëm të përmbledhjes “Dyzet hadithet” për të shpjeguar se, parimi universal themelor kur`anor i lirisë së fesë dhe besimit i refuzon të gjitha interpretimet e tjera dhe se dënimi mesjetar me vdekje për apostazi ka qenë i shfuqizuar zyrtarisht nga el Sheikh - Islami i kalifatit osman, si dhe nga al-Az-hari i Egjiptit.

Shtojca Dy: Një reflektim rreth Islamit dhe Lirisë së Fesë

Pas bujës ndërkombëtar në vitin 2012 mbi filmin amatoresk, inflamator dhe fyes, “*Pafajësia e myslimanëve*”, ka pasur thirrje në mbarë botën për të futur³⁰ ose forcuar

³⁰ p.sh. Peshkopët Anglikanë në Lindjen e Mesme i shkruan Ban Ki Munit, sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, duke i kërkuar për një deklaratë që nxjerrë jashtë ligjit”

rregullat që do të bëhen të ngjashme me ligjet globale ndaj blasfemisë.³¹ Dhjetëra njerëz janë vrarë gjatë protestave të dhunshme në shtete me shumicë myslimane, përfshirë Ambasadorin e SHBA-ve, Stivens në Libi nga një sulm terrorist nën mbulesën e protestave anti-film, ndërsa një ministër pakistanez vendosi një çmim prej 100.000 \$ për kokën e drejtorit të filmit.

Për shumë nga ne, ky ishte një rast si “Ja

fyerje të qëllimshme ose shpifje ndaj personave (si profetët), simboleve, teksteve dhe strukturave të besimeve që konsiderohen nga njerëz besimtarë” (Anglican Communion News Service, Anglican leaders condemn anti-islam film and violence, 19 September 2012, <http://www.anglicancommunion.org/acns/news.cfm/2012/9/19/ACNS5185>).

³¹ cituar nga: deklarata e Përfaqësuesve të Përhershëm të shteteve anëtare të OIC në OKB, OIC Grupi i Nju Jorkut dënon daljen e videos anti myslimane dhe bën thirrje për aksion kolektiv kundër provokacioneve dhe nxitjeve sistematike të urrejtjes, 22/Shtator/ 2012, http://www.oic-oci.org/topic_detail.asp?t_id=7189.

ku jemi përsëri”. Nga librat, filmat, karikaturat, arushat e pelushit dhe përdhosje të kopjeve të Kur’anit nga një grusht fundamentalistësh dhe ushtarësh amerikanë, historia është e njëjtë. Në vend të injorimit të materialit fytes dhe ofendues për Islamin, apo në vend të faljes së autorëve të tyre, siç do kish bërë profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të), disa myslimanë të papjekur i jepen dhunës, që përfundon deri në vrasje njerëzish të cilët kanë bërë mirë, më shumë se shumë të tjerë, për të ndihmuar myslimanët ose shtetet me shumicë myslimane. Për më tepër, materiali “ofenduese” i cilësisë së dobët merr publicitet shumë më tepër se meriton, dhe imazhi i Islamit është zvarritur nëpër baltë përsëri, duke nervozuar shumicën dërrmuese të myslimanëve të thjeshtë e të denjë.

Në vitin 1980, vjershat satanike të Selman Rushdisë, një libër i ngarkuar me pasthirrma të pista, libër kryesisht i palexueshëm, u bë shumë shpejt me famë ndërkombëtare, së bashku me autorin e tij, nga një fushatë islamike për “ngritje të

vetëdijes” nga publikimi i fyerjeve satirike ndaj figurave të shenjta të Islamit, që kulminoi në fetvanë famëkeqe të Ajatollah Homeinit, duke urdhëruar vrasjen Rushdisë. E njëjta histori u përsërit, dy dekada më vonë, me karikaturat daneze që satirizuan Profetin Muhammed (paqja qoftë mbi të). Këto ishin kryesisht të panjohura, kur u botuan për here të parë, derisa kleriku egjiptian i bazuar në Danimarkë nisi një fushatë publikimi të tyre. Sigurisht, të duash Profetin dhe dishepujt e tij, nuk do të thotë që të publikosh fyerjet bruto të drejtuara ndaj tij. Nëse shajnë edhe të dashurit tanë si; prindërit, fëmijët ose vëllezërit e motrat, a do t’i transmetojnë ne këto komente ofenduese ose përshkrime për të gjithë botën që t’i shohël

Në të gjitha këto raste, dhjetëra njerëz të zakonshëm vdiqën në trazira dhe protesta nëpër botë: kjo është jashtëzakonisht ironike, kur vetë Profeti thuhet se ka mësuar se edhe shkatërrimi i Qabes, vendi më i shenjtë i Islamit, është më e lehtë në sytë e Zotit se sa marrja e një jete të vetme.

Më poshtë sjellim incidente veçanërisht të t errshme gjatë vitit 2011:

a) Një grupi njerëzi h nga stafi isOKB-së, të cilët duruan shumë vështirësi për të ndihmuar Afganistanin , një komb ky pra me shumicën dërrmuese myslimane, iu prenë kokat pas një proteste të turmave të dhunshme kundër djegies së Kur`anit që bëri një grusht i papërfillshëm evangjelistësh nga SHBA.³²

b) Salman Taseer, Guvernatori i provincës Punjab në Pakistan, u vra nga një prej truprojave të tij, i cili më vonë e akuzoi Taseer-in si “Fyerës i Profetit”, duke ndërhyrë për të siguruar një falje presidenciale në rastin e Azia Bibit, një grua e krishterë pakistaneze cila u dënua me vdekje sipas lidhjeve të blasfemisë në një situatë të dyshuar për përfshirje gjakrash fqinjësore me myslimanët.